



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
NJOFTIM

PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBJENTEVE PËR QËLLIME MAGAZINIMI

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të tij ligjore dhe funksioneve organizative, vlerëson të nevojshme sigurimin me qira të një ambienti të përshtatshëm, që do të shërbejë si magazinë e përkohshme për vendosjen e materialeve në pronësi të institucionit.

Kjo nevojë lind si rezultat i kërkesës për hapësira funksionale gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve të rikonstruksionit në godinën në pronësi të AKEP-it dhe procesit të transferimit në zyrat e reja.

I. KËRKESAT DHE SPECIFIKIMET KRYESORE PËR AMBIENTE MAGAZINIMI

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) kërkon me qira ambiente të përshtatshme për përdorim si magazinë e përkohshme, për vendosjen e materialeve në pronësi të institucionit. Ambientet duhet të plotësojnë kërkesat dhe specifikimet e mëposhtme minimale:

- Ambienti i magazinimit duhet të ketë një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme jo më pak se **200 m²** dhe jo më shumë se **300 m²** dhe të jetë i përshtatshëm për përdorim administrativ dhe magazinim, duke përmbushur kërkesat minimale ligjore për hapësira pune.
- Ambienti i magazinimit duhet të jetë i pozicionuar në kate të ulëta, konkretisht në katin e parë teknik. Preferohet të ketë edhe ashensor.
- Ambienti i magazinimit, ku do të vendosen materialet e AKEP-it, duhet të jetë i pozicionuar **jo më larg se rrethinat e Tiranës**.
- Ambienti i magazinimit duhet të jetë i pajisur me të paktën **dy fikse zjarri**, në përputhje me kërkesat e sigurisë kundër zjarrit.
- Ambienti i magazinimit duhet të ketë **furnizim të pandërprerë me energji elektrike**, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.
- Ambienti i magazinimit duhet të ketë **ndriçim të mjaftueshëm**.
- Ambienti i magazinimit duhet të ketë **izolim efektiv kundër lagështirës**, për të garantuar ruajtjen e materialeve.
- Ambienti i magazinimit duhet të jetë në gjendje të tillë që të mundësojë të gjitha kushtet, pa pasur **nevojë për kryerjen e investimeve shtesë nga AKEP**.
- Ambienti i magazinimit duhet të jetë **bosh dhe të lira nga çdo detyrim apo ngarkesë** në momentin e dorëzimit.
- Të mundësojë **survejim/monitorim me sistem kamerash** të cilat do monitorohen dhe aksesohen online.
- Të mundësojë Operimin në ambjentet e mara me qera pa probleme me të Tretët.

- Ofertuesi të deklarojë se, në rastin e nevojës së AKEP për zgjatjen kohore të kontratës së qerasë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj, do të jetë pa ndryshime dhe kërkesa të ndryshme nga kontrata e fillestare.
- Dorëzimi i objektit dhe efektet financiare të kontratës do fillojnë **brenda datës 15 Dhjetor 2025**.

II. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR KUALIFIKIM

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm në mbështetje të ofertës së tij:

1. Dokumentacion që vërteton të drejtën e pronësisë – Çertifikatë pronësie ose dokument tjetër ligjor që provon se ofertuesi e zotëron pronën në mënyrë të ligjshme.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (ID) të përfaqësuesit ligjor ose të personit fizik ofertues.
3. Planimetrinë e ambientit që ofrohet me qira.
4. Nëse ofertuesi është tregtar ose shoqëri tregtare, duhet të paraqesë gjithashtu:
 - NIPT/NUIS dhe Çertifikatën e Regjistrimit, si dhe Ekstraktin Historik të subjektit, që vërteton se subjekti ka status aktiv;
 - Vërtetim nga administrata tatimore që konfirmon se nuk ka detyrime të pashlyera tatimore;
 - Vërtetim nga sistemi “e-Sigurime” që dëshmon se subjekti nuk ka detyrime të pashlyera ndaj sigurimeve shoqërore.
5. Vërtetim të gjendjes gjyqësore që konfirmon se ofertuesi nuk është në ndjekje penale dhe nuk ndodhet në proces gjyqësor.
6. Deklaratë mbi mungesën e konfliktit të interesit me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).
7. Vetëdeklarim mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe kërkesave të sigurisë teknike të përcaktuara në dokumentet e procedurës.
8. Dokumentacioni që lëshohet nga institucione shtetërore duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar, dhe duhet të jetë i lëshuar brenda tre (3) muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

III. DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT DHE OFERTËS EKONOMIKE

1. Dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jetë i futur në një zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e ofertuesit. Mbi zarf duhet të jetë shënuar: **“Ofertë për marrjen me qira të ambjenteve për qëllime magazinimi”**.
2. Oferta e qiradhënësit që specifikon sipërfaqen dhe çmimin mujor (në LEKE) të qerasë për m² sipërfaqe, për një periudhë jo më pak se **6 (gjashtë) muaj** sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emri dhe NIPT-11 subjektit	Përshkrimi	Sipërfaqja totale në m ²	Cmimi për m ² / muaj (në Lekë)	Sasi kohëzgjatja	Vlera totale (në Lekë)

3. Dorëzimi i dokumentave dhe ofertës ekonomike duhet të bëhet brenda datës **10.11.2025**, ora **16:00**, me postë ose dorazi pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me adresë: Rr. “Reshit Çollaku” Tiranë.

4. Ofertuesi duhet të pranojë që pagesa e qirasë të bëhet çdo muaj në lekë, bazuar në çmimin e ofruar dhe sanksionuar në kontratën e qirasë, kundrejt lëshimit të faturës tatimore nga subjekti/ ose kërkesës për pagesë nga individi.

IV. KRITERE VLERËSUESE

Oferta fituese do të jetë ajo që ofron çmimin më të ulët (oferta ekonomikisht më e favorshme) dhe që plotëson të gjitha kriteret teknike, ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për marrjen me qira të ambienteve të magazinimit.

KRYETARI

Gentian Sala

DEKLARATË PËR PËRMBUSHJEN E KËRKESAVE TEKNIKE

(Për t'u dorëzuar nga ofertuesi pjesëmarrës)

Drejtuar: Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Objekti: **“Marrje me qira ambiente magazinimi për AKEP”**

Data e zhvillimit të procedurës: _____2025, ora ____:00

Unë, i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të Ofertuesit _____, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Ne përmbushim të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e publikuara dhe këtë e vërtetojmë me certifikata dhe dokumente të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.
2. Objekti që ofrojmë me qira respekton të gjitha kërkesat e përcaktuara nga AKEP-i.

Data e dorëzimit të deklaratës: _____2025

Nënshkrimi i ofertuesit: _____

OFERTË EKONOMIKE

(Për t'u dorëzuar nga ofertuesi pjesëmarrës)

Emri i Ofertuesit: _____

Drejtuar: Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Prokurimi: Marrje ambienti me qira / _____ 2025

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Marrje me qira ambiente magazinimi për AKEP”**

Në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të prokurimit për procedurën në fjalë, unë, Ofertuesi _____, deklaroj sa më poshtë:

1. Çmimi total i ofertës sonë është: _____ [monedha dhe vlera në lekë]

Nr.	Emri dhe NIPT-11 subjektit	Përshkrimi	Sipërfaqja totale në m2	Cmimi për m2 / muaj (në Lekë)	Sasi kohëzgjatja	Vlera totale pa TVSH (në Lekë)
Çmimi Neto)						
Çmimi Total						

Kohëzgjatja e kontratës: _____

Afati i ofrimit të shërbimit: _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi dhe vula e ofertuesit: _____

**DEKLARATË PËR MOSKEKZISTENCËN
E KONFLIKTIT TË INTERESIT**

(Për t'u dorëzuar nga ofertuesi pjesëmarrës)

Drejtuar: Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
Objekti i prokurimit: **“Marrje me qira ambiente magazinimi për AKEP”**
Data e zhvillimit të procedurës: _____2025, ora ____:00

Unë, _____ i _____ nënshkruari _____,
me funksionin _____, përfaqësues ligjor i Ofertuesit
_____, që merr pjesë në procedurën e
sipërpërmendur,

deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore se:

- Nuk ndodhemi në kushtet e konfliktit të interesit as unë personalisht dhe as persona të tjerë me të cilët kam lidhje gjaku ose shoqërore nuk kemi ndonjë lidhje pune, kontraktuale apo përfitimi të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë me personat që përfaqësojnë ose marrin pjesë në emër të AKEP në këtë procedure qiraje;
- Nuk kemi ndikuar dhe nuk do të përpiqemi të ndikojmë në mënyrë të padrejtë mbi vendimmarrjen e institucionit;
- Në rast se gjatë zhvillimit të procedurës do të konstatohet ndonjë situatë që bie ndesh me këtë deklaratë, angazhohem të njoftoj menjëherë AKEP-in dhe të marr masat e nevojshme për përjashtimin nga procedura, sipas parashikimeve ligjore.

Data: _____2025

Emri i përfaqësuesit të autorizuar: _____

Pozicioni: _____

Nënshkrimi: _____

Vula e ofertuesit